

**Akt Themelimi i Shoqërisë Tregtare “METAL WORK FE & AL”  
sh.p.k**

**Bazuar** në ligjin nr. 9901 dt. 14.04.2008 “për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligjin 9723 dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe në ligjet e tjera që lidhen me veprimtarinë tregtare në Republikën e Shqipërisë me vullnetin time të lirë:

**Z. Sidorel Mema e Dtl. 19.12.1989** lindur në Peqin dhe banues në Elbasan me kartë identiteti nr. **191219010M**

**Z. Fatmir Pema e Dtl. 24.01.1987** lindur në Griqan dhe banues në Elbasan me kartë identiteti nr. **170124016J**

**Formimi**

Neni 1

Sot me Dt. 15/01/2024 formohet shoqëria tregtare private e quajtur “**METAL WORK FE & AL**” sh.p.k. Shoqëria do t'i nënshtrohet legjislacionit shqiptar ndërsa degët që mund të krijohen do t'i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

**Selia e Shoqërisë**

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare private “**METAL WORK FE & AL**” sh.p.k do të ketë selinë në: **Elbasan, Bradashesh, fshati Katund I Ri, rruga Elbasan-Bradashesh km-5, zk.2124, pasuria nr.352/12**. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve të shoqërisë.

**Objektivi i Veprimtarisë**


**Konstruksione metalike.**

Neni 3

**Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat më shumë se 10 vjet. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.



## Kapitali i Shoqërisë

### Neni 5

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 lekë.
2. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtëm:
3. a. Ortaku themelues **Sidorel Mema** zotëron 1 kuotë me vlerë të përgjithshme 50,000 lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë.
4. . Ortaku themelues **Fatmir Pema** zotëron 1 kuotë me vlerë të përgjithshme 50,000 lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë

## Drejtimi i Shoqërisë

### Neni 6

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj dhe përfaqësuesi ligjor i saj **Z. Sidorel Mema** për një periudhë **5-vjeçare**. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme.

### Neni 7

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve të shoqërisë.

### Neni 8

Ortaku i vetëm themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorët e tjerë të vlerave materiale. Ka të drejtë të caktojë financiere, likuidator për problemet e shoqërisë dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë.

### Neni 9

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar.

### Neni 10

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme me tekstin rreth saj.

### Neni 11

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Krijimin e Shoqërive Tregtare" si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullat që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

### Neni 12



Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “**METAL WORK FE & AL**” sh.p.k. Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e shoqërisë.

**Ortaku i shoqërisë “METAL WORK FE & AL”**

**Sidorel Mema**

A handwritten signature in blue ink, consisting of a series of loops and a long horizontal stroke extending to the left.

**Fatmir Pema**

A handwritten signature in blue ink, featuring a stylized 'F' and 'P' intertwined.